

RRETH REMITENCAVE




Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



QËLLIMET E MËSIMNXËNIES

- PËRKUFIZIMI I REMITENCAVE
- FORMAT E REMITENCAVE
- ARSYET PSE EMIGRANTËT DËRGOJNË REMITENCA
- FAKTE MBI REMITENCAT
- PËRDORIMI I REMITENCAVE
- REMITENCAT DHE INVESTIMET NË BIZNES

Procedures for overseas remittance through existing banks



$$\text{Remittance Amount} - \text{Transfer Fee} - \text{Telegraphic Fee} - \text{Relay fee} - \text{Exchange Fee} - \text{Receipt Fees} = \text{Amount Received}$$

ÇKA JANË REMITENCAT?

REMITENCAT JANË “NJË SHUMË E PARAVE QË I DËRGOHEN DIKUJ PËR TË PAGUAR PËR DIÇKA.”

OXFORD ONLINE DICTIONARY

PRA,

REMITENCAT E EMIGRANTËVE PARAQESIN NJË SHUMË TË PARAVE QË EMIGRANTËT UA DËRGOJNË FAMILJEVE TË TYRE QË JETOJNË NË SHETIN AMË

DY FORMAT E REMITENCAVE

- EKZISTOJNË DY FORMA TË REMITENCAVE:
 - TRANSFERET NË PARA TË GATSHME
 - EMIGRANTËT IU DËRGOJNË PARA TË GATSHME FAMILJEVE
 - TRANSFERET NË NATYRË
 - EMIGRANTËT IU DËRGOJNË TË MIRA TË NDRYSHME FAMILJEVE

PSE DËRGOJNË EMIGRANTËT REMITENCA?

- **ARSYET** PSE EMIGRANTËT DËRGOJNË REMITENCA PËRFSHIJNË:
 - PËR TA NDIHMUAR FAMILJEN NË PLOTËSIMIN E NEVOJAVE USHQIMORE
 - PËR TA NDIHMUAR FAMILJEN NË BLERJEN APO RENOVIMIN E SHTËPISË/BANESËS
 - PËR TË INVESTUAR NË SHKOLLIMIN E FËMIJËVE
 - PËR TË INVESTUAR NË BIZNES
 - PËR TA PAGUAR BORXHIN E MARRË PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË EMIGRIMIT
 - PËR TË NDIHMUAR NË MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË EMIGRIMIT PËR ANËTARËT TJERË TË FAMILJES

PSE DËRGOJNË EMIGRANTËT REMITENCA?

- A JU KUJTOHET ANDRA NGA MODULI “RRETH MIGRACIONIT”?
- ANDRA I DËRGON REMITENCA FAMILJES
- MOTRA E SAJ ZANA KA FILLUAR TË DISKUTOJË ME ANDRËN DHE FAMILJEN RRETH IDESË PËR TË INVESTUAR NË NJË FURRË BUKE
- ZANA KA PROPOZUAR QË T’I PËRDORIN REMITENCAT QË I DËRGON ANDRA DHE TË ARDHURAT E FAMILJES PËR TË FINANCUAR THEMELIMIN E FURRËS SË BUKËS



FAKTE MBI REMITENCAT

- A E DINI QË
 - GJATË PANDEMISË COVID-19, EMIGRANTËT KOSOVARË U KANË DËRGUAR FAMILJEVE MË SHUMË REMITENCA KRAHASUAR ME NJË VIT MË HERËT
 - GJATË 2020, REMITENCAT QË EMIGRANTËT KOSOVARË UA KANË DËRGUAR FAMILJEVE ARRITËN SHUMËN PREJ 980 MILIONË EURO
 - GJATË 2021, REMITENCAT KANË ARRITUR VLERËN PREJ **1.153 MILIARD EURO**
 - **PRA, REMITENCAT JANË RRITUR PËR 173 MILIONË EURO**

FAKTE MBI REMITENCAT


- A E DINI QË
 - GJERMANI ËSHTË VENDI KRYESOR PREJ NGA VIJNË REMITENCAT
 - HISTORIKISHT, RRETH 40% E REMITENCAVE KANË ARDHUR NGA EMIGRANTËT KOSOVARË QË JETOJNË NË GJERMANI
 - **GJATË 2021, 39.2% E REMITENCAVE KANË ARDHUR NGA GJERMANIA**
 - **PRA, RRETH 450 MILIONË EURO REMITANCA KANË ARDHUR NGA GJERMANIA GJATË 2021**

FAKTE MBI REMITENCAT

- A E DINI QË
 - RRETH NJË NË KATËR EKONOMI SHTËPIAKE NË KOSOVË PRANON REMITENCA
 - RRETH 30% E PRANUESVE TË REMITENCAVE JANË EKONOMI SHTËPIAKE ME **KRYEFAMILJARE GRUA**
 - GJATË 2021, SHUMA MESATARE MUJORE E REMITENCAVE QË KANË PRANUAR EKONOMITË SHTËPIAKE KOSOVARE KA QENË RRETH 250 EURO (*STUDIM I REALIZUAR NGA DFD*)
 - GJASAT QË TË PRANOJNË REMITENCA JANË GATI TË NJËJTA NË MES TË FAMILJEVE QË JETOJNË NË ZONA RURALE DHE ATYRE QË JETOJNË NË ZONA URBANE

PËR ÇKA PËRDOREN REMITENCAT?

- EKONOMITË SHITËPIAKE KOSOVARE PJESËN MË TË MADHE TË REMITENCAVE, RRETH 75%, E PËRDORIN PËR T'I PLOTËSUAR NEVOJAT PËR USHQIM
- VETËM RRETH 5.5% E REMITENCAVE PËRDOREN PËR INVESTIME NË BIZNES
(STUDIM I REALIZUAR NGA DFD)



REMITENCAT DHE INVESTIMET NË BIZNES

***PARAMENDOJENI SE SA BIZNESE DO TË ZHVILLOHESHIN, SIKUR MË SHUMË SE 5.5% E 1.15 MILIARD
EURO REMITENCA TË INVESTOHESHIN NË BIZNES!***

REMITENCAT DHE INVESTIMET NË BIZNES

***PARAMENDOJENI SE SA BIZNESE DO TË ZHVILLOHESHIN, SIKUR FAMILJET KOSOVARE T'I PËRDORNIN
NJOHURITË MBI BIZNESIN DHE LIDHJET BIZNESORE TË ANËTARËVE TË TYRE QË JETOJNË NË
GJERMANI!***

REMITENCAT DHE INVESTIMET NË BIZNES

- NË KOSOVË, NORMA E PAPUNËSISË TE GRATË ËSHTË 33%
 - DHE VETËM 21% ËSHTË NORMA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË FUQINË PUNËTORE
- RRETH 30% E PRANUESVE TË REMITENCAVE JANË EKONOMI SHTËPIAKE ME **KRYEFAMILJARE GRUA**
- **PARAMENDOJENI SE SA BIZNESE ME PRONARE GRA DO TË ZHVILLOHESHIN, SIKUR FAMILJET KOSOVARE T'I PËRDORNIN REMITENCAT, SI DHE NJOHURITË MBI BIZNESIN DHE LIDHJET BIZNESORE TË ANËTARËVE EMIGRANTË!**

REMITENCAT DHE INVESTIMET NË BIZNES

- ***ÇKA MENDONI SE ËSHTË E DOMOSDOSHME PËT T'I NXITUR FAMILJET QË REMITENCAT T'I INVESTOJNË NË BIZNES?***

REMITENCAT DHE INVESTIMET NË BIZNES

Ja çka i duhet Zanës dhe familjes së saj për t'u nxitur që remitencat t'i investojnë në biznes!

Shkathtësitë mbi
financat

Informatat mbi
grantet dhe
subvencionet
qeveritare

Informata mbi
makerspaces,
inkubatorët dhe
këshillimet biznesore

Informata mbi atë
se si të aplikojnë
për kredi

Shkathtësi
menaxheriale

Shkathtësi
ndërmarrëse



Njohuri mbi atë se si
të bëjnë hulumtimin
e tregut

Informata mbi atë
se si të paguajnë
tatimet

PYETJA 1

- REMITENCAT PARAQESIN NJË SHUMË TË PARAVE QË EMIGRANTËT UA DËRGOJNË FAMILJEVE TË TYRE QË JETOJNË NË SHTETIN AMË.
 - A. E SAKTË
 - B. E PASAKTË

PYETJA 2

- ARSYET PSE EMIGRANTËT DËRGOJNË REMITENCA JANË:
 - A. PËR TA NDIHMUAR FAMILJEN NË PLOTËSIMIN E NEVOJAVE USHQIMORE
 - B. PËR TA NDIHMUAR FAMILJEN NË BLERJEN APO RENOVIMIN E SHTËPISË/BANESËS
 - C. PËR TË INVESTUAR NË SHKOLLIMIN E FËMIJËVE
 - D. TË GJITHA

PYETJA 3

- GJERMANIA ËSHTË VENDI KRYESOR PREJ NGA VIJNË REMITENCAT, SEPSE
 - A. HISTORIKISHT, RRETH 40% E REMITENCAVE KANË ARDHUR NGA GJERMANIA
 - B. HISTORIKISHT, VETËM 10% E REMITENCAVE KANË ARDHUR NGA GJERMANIA
 - C. HISTORIKISHT, RRETH 15% E REMITENCAVE KANË ARDHUR NGA GJERMANIA
 - D. TË GJITHA

PYETJA 4

- RRETH 30% E PRANUESVE TË REMITENCAVE JANË EKONOMI SHTËPIAKE ME **KRYEFAMILJARE GRUA**.
 - A. E SAKTË
 - B. E PASAKTË

PYETJA 5

- KËTA JANË FAKTORËT KRYESORË QË NXISIN FAMILJET PËR TË INVESTUAR REMITENCAT NË BIZNES:
 - A. INFORMATAT MBI GRANTET DHE SUBVENCIONET QEVERITARE
 - B. SHKATHTËSITË FINANCIARE
 - C. SHKATHTËSITË NDËRMARRËSE DHE MENAXHERIALE
 - D. TË GJITHA

REFERENCAT

- [HTTPS://WWW.YOUTUBE.COM/WATCH?V=3I3UURDUDAM](https://www.youtube.com/watch?v=3I3UURDUDAM)
- [HTTPS://WWW.YOUTUBE.COM/WATCH?V=P38C0KNXDËU](https://www.youtube.com/watch?v=P38C0KNXDËU)
- [HTTPS://WWW.YOUTUBE.COM/WATCH?V=TAVA_COEEOI](https://www.youtube.com/watch?v=TAVA_COEEOI)
- [HTTPS://WWW.YOUTUBE.COM/WATCH?V=OËC-HB67DLM](https://www.youtube.com/watch?v=OËC-HB67DLM)
- [HTTPS://BQK-KOS.ORG/STATISTIKAT/SERITE-KOHORE/](https://BQK-KOS.ORG/STATISTIKAT/SERITE-KOHORE/)
- [FINANCIAL SERVICES KOSOVO ENGLISH \(EDITABLE\) \(BQK-KOS.ORG\)](#)
- [REMITTANCES - A GATEWAY...ALB \(BQK-KOS.ORG\)](#)